



**SHTYLLA I  
LEGJISLACIONI SHQIPTAR**

**Pakti për Universitetin dhe Ligji për Arsimin e Lartë**

*Nga Av. Holta Ymeri*

**I. ABSTRAKTI**

Për shkak të protestave të studentëve është hapur një debat i gjerë publik në lidhje me sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri. Si rrjedhojë e këtyre protestave qeveria shqiptare miratoi “Paktin për Universitetin” të përbërë nga disa akte nën-ligjore. Ky shkrim ka për qëllim të analizojë **disa** prej kërkesave të studentëve dhe akteve nën-ligjore të Paktit për Universitetin si dhe aspektet thelbësore të Ligjit për Arsimin e Lartë. Më konkretisht në paragrafin II analizohet kërkesa për rritjen e financimit publik deri në 5% të PBB-së. Në paragrafin III analizohen vendimet e këshillit të ministrave për përgjysmimin e tarifave të ciklit të parë (Bachelor) dhe të ciklit të dytë (Master). Në paragrafin IV analizohet kërkesa për rritjen nga 10% në 50% të peshës totale të votës së studentëve për të zgjedhur dekanin dhe rektorin. Në paragrafin V analizohet kërkesa në lidhje me përbërjen e Bordit të Administrimit. Në paragrafin VI analizohen dy aspekte thelbësore analizohet kërkesa për shfuqizimin e Ligjit për Arsimin e Lartë. Paragrafi VII jep në mënyrë të përmbledhur përfundimet e analizës për secilën pikë dhe disa rekomandime.

**FJALË KYÇE:** *Arsimi i Lartë; IAL; Studentët; Tarifa; Autonomi; Ligji për Arsimin e Lartë*

**SHKURTIME**

<b>ASCAL</b>	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>PBB</b>	Prodhimi i Brendshëm Bruto
<b>Kodi i Cilësisë</b>	VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”.
<b>IAL</b>	Institucion i Arsimit të Lartë
<b>IALPP</b>	Institucion Publik i Pavarur i Arsimit të Lartë
<b>LSI</b>	Lëvizja Socialiste për Integrim
<b>Ligji 80/2015</b>	Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”
<b>Manifesti</b>	Manifesti 2017-2021 i paraqitur si program elektorale nga PS gjatë fushatës elektorale të po të njëjtës periudhë
<b>PS</b>	Partia Socialiste e Shqipërisë
<b>Programi 2013-2017</b>	Programi i Qeverisë 2013-2017 paraqitur gjatë fushatës elektorale nga Aleanca për Shqipërinë Evropiane
<b>PBA</b>	Programi Buxhetor Afatmesëm
<b>PBA 2019-2021</b>	VKM Nr. 731, datë 12.12.2018 “Për miratimin e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm të rishikuar 2019-2021”
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

## II. RITJA E FINANCIMIT PUBLIK DERI NË 5% PBB<sup>1</sup>

Ritja e financimit për arsimin publik deri në 5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), e cila është kërkesa e parë<sup>2</sup> në listën e studentëve ka qenë gjithashtu objekt i programeve elektorale të Qeverisë aktuale (për vitet 2013-2017<sup>3</sup> dhe vitet 2017-2021)<sup>4</sup>.

**Programi i qeverisë 2013 – 2017 (Programi 2013 - 2017)** i paraqitur nga Aleanca për Shqipërinë Evropiane<sup>5</sup> përbante 5 shtylla kryesore: Integrimi në BE; Shqipëria Evropiane në rajon dhe në botë; shteti i së drejtës dhe demokratizimi i shoqërisë; zhvillimi ekonomik dhe shërbimet publike. Sektori i arsimit, edhe pse konsiderohet si sektor strategjik nga vetë ky program, nuk është trajtuar në shtyllën e zhvillimit ekonomik, por është përfshirë në shtyllën e shërbimeve publike<sup>6</sup>. Kjo qasje që konsideron sektorin e arsimit thjesht si një shërbim publik, të krahasueshëm për shembull me transportin publik, bie ndesh me vetëdijen e konsoliduar edhe ndërkombëtarisht, se Arsimi është një nga elementet e rëndësishme të zhvillimit ekonomik. Një studim i Bankës Botërore i vitit 2017 mbi arsimin e lartpërmend ndër të tjera se *'studimet ekonomike dhe veçanërisht ato studime të cilat marrin parasysh cilësinë e arsimit, kanë treguar se ekziston një marrëdhënie pozitive midis arsimimit dhe rritjes ekonomike, (Barro 2013; Hanushek and Woessmann 2008, 2012)'*<sup>7</sup>. Por pavarësisht konceptit të cunguar politik për sektorin e arsimit, Programi 2013-2017 përcaktonte shprehimisht synimin që financimi publik për arsimin të arrinte nivelin 5% të PBB-së<sup>8</sup>. Ky objektivi nuk u përmbush gjatë periudhës qeverisëse 2013-2017.

**Manifesti 2017-2021 (Manifesti)**, i cili është programi elektorale i qeverisë aktuale, përmban një kapitull në lidhje me premtimet për të cilat ende po punohet. Mes tyre është edhe premtimi i rritjes së financimit për arsimin publik deri në 5% të PBB-së<sup>9</sup>. Megjithatë ky objektivi rezultoi ende i papërmbushur gjatë pjesës së parë të këtij mandati qeverisë, siç vërtetohet nga fakti se për vitin 2018 financimi në arsimin publik është në nivelin prej 3.1% të PBB-së<sup>10</sup>.

Si pasojë e kërkesës së studentëve ky premtim elektorale u rikthye në vëmendjen publike. Me shpalljen e Paktit për Universitetin, kryeministri në datën 26 dhjetor 2018 trajtoi shkurtimisht këtë argument duke pohuar se buxheti për sektorin e arsimit do të jetë në rritje, ndërsa çështja e financimit me deri 5% të PBB-së ishte ende në diskutim dhe nuk kishte ende përgjigje për të<sup>11</sup>.

<sup>1</sup>Kërkesa 1: Rritja e buxhetit në 5% GDP me qëllim përgjysmimin e tarifës së studimit për çdo nivel studimi, përmirësimin e mësimdhënies dhe infrastrukturës (Universitete / Konvikte).

<sup>2</sup><http://top-channel.tv/2018/12/09/protesta-studentet-perpilojne-kerkesat-e-panegociueshme/>

<sup>3</sup>[http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Programi\\_Qeverise.pdf](http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Programi_Qeverise.pdf)

<sup>4</sup><https://www.ps.al/programi/manifest-2017-2021>

<sup>5</sup>E përbërë nga koalicioni i dy forcave politike: Partia Socialiste (PS) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI).

<sup>6</sup>Programi 2013-2017, fq. 47.

<sup>7</sup>World Bank Group, Higher Education for Development, An Evaluation of the World Bank Group's Support, Washington DC, 2017, Pg.1.

<https://ieg.worldbankgroup.org/sites/default/files/Data/Evaluation/files/highereducation.pdf>

<sup>8</sup>Programi 2013-2017, fq. 47.

<sup>9</sup>Manifesti, fq. 82.

<https://www.ps.al/programi/manifest-2017-2021>

<sup>10</sup>VKM Nr. 731, datë 12.12.2018 "Për miratimin e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm të rishikuar 2019-2021", fq.12475.

<sup>11</sup>Kryeministri Edi Rama, për dokumentin e punës për Paktin për Universitetin: "Përsa i përket 5% të GDP-së nuk u zgjata për këtë, por në Paktin për Universitetin. Edhe kjo çështje do të jetë e shpjeguar më së miri, me të gjithë argumentet dhe kontributet e shqiptarëve përmes buxhetit në arsim do të shkojnë duke u rritur dhe do të shpjegohen

Pavarësisht pohimeve të mësipërme, 14 ditë përpara shpalljes së Paktit për Universitetin është miratuar nga Këshilli i Ministrave VKM Nr. 731, datë 12.12.2018 “Për miratimin e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm të rishikuar 2019-2021” (PBA 2019-2021). PBA është një instrument për planifikimin e buxhetit me anë të të cilit qeveria planifikon financimet nga buxheti i shtetit për 3(tre) vjeçarin e ardhshëm<sup>12</sup>. Sipas PBA 2019-2021 është e qartë se në 3 (tre) vitet në vijim qeveria shqiptare nuk ka planifikuar të rrisë financimin e sektorit të arsimit deri në masën prej 5% të PBA-së. Për më tepër pjesa e PBB-së që planifikohet të shkojë për arsimin gjatë këtij 3 (tre) vjeçari vjen në rënie. Tabela 1 më poshtë jep të dhënat konkrete të marra nga Tabela 5 e PBA 2019-2021<sup>13</sup>:

**Tabela 1 – Përqindja e PBB-së për Arsimin 2018-2021**

	2018	PBA 2019	PBA 2020	PBA 2021
<b>Arsimi % PBB</b>	<b>3.1%</b>	<b>3.3 %</b>	<b>3.2 %</b>	<b>3.0%</b>

Bazuar në gjendjen aktuale të planifikimit financiar dhe akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave është e qartë se **kërkesa e studentëve për rritjen e financimit të sektorit të arsimit publik në masën prej 5% të PBB-së nuk do të realizohet gjatë viteve 2019-2021**. Realizimi i kësaj kërkesë mund të bëhet vetëm pasi të riplanifikohen financimet publike të përfshira në PBA-në 2019-2021 dhe të ndryshohet ligji për buxhetin e shtetit të vitit 2019.

### III. PËRGJYSMIMI I TARIFAVE

Një nga kërkesat e studentëve është edhe **përgjysmimi i tarifave për çdo nivel studimi**<sup>14</sup>. Sipas Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (Ligji 80/2015) ekzistojnë tre cikle studimi: (i) **Cikli i parë** i studimeve ose ndryshe studimet Bachelor<sup>15</sup>; (ii) **Cikli i dytë** i studimeve që përfshijnë Masterin e shkencave, Masterin e Arteve dhe Masterin Profesional<sup>16</sup>; (iii) **Cikli i tretë** i Studimeve që përfshijnë Masterin ekzekutiv, Specializimet afatgjata dhe Studimet e doktoratës<sup>17</sup>.

Tarifat për **ciklin e parë** të studimeve përcaktohen bashkarisht nga qeveria dhe Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) Publike. Qeveria (sipas propozimit të Ministrisë së Arsimit) miraton me VKM kufijtë maksimal / tavanin e tarifës së shkollimit për ciklin e parë të studimeve<sup>18</sup>. Brenda këtij tavani IAL-et

më së miri “si”, “kur”, dhe “pse” nuk është e mundur kjo sot, apo ajo nesër. Por nuk e thashë këtu, meqenëse s’kemi ndonjë përgjigje për këtë”.

<https://www.kryeministria.al/newsroom/mbi-dokumentin-e-punes-mbi-paktin-per-universitetin/>

<sup>12</sup><http://shtetiweb.org/2014/11/08/programi-buxhetor-afatmesem/>

<sup>13</sup>VKM Nr. 731, datë 12.12.2018 “Për miratimin e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm të rishikuar 2019-2021”, Tabela 5, fq.12475.

<sup>14</sup><http://top-channel.tv/2018/12/09/protesta-studentet-perpilojne-kerkesat-e-panegociueshme/>

<sup>15</sup>Neni 73, Ligji 80/2015.

<sup>16</sup>Neni 75, Ibid.

<sup>17</sup>Neni 77, Ligji 80/2015.

<sup>18</sup>Neni 7 (2) (f) i Ligjit 80/2015.

publike kanë mundësinë të përcaktojnë tarifatat përkatëse. Tarifatat për **ciklin e dytë dhe të tretë** të studimeve të larta përcaktohen lirisht nga IAL-et publike. Ligji 80/2015 nuk përmban orientime konkrete në lidhje me kriteret që përdoren për përcaktimin e këtyre tarifave. Për të ilustruar më konkretisht masën e tarifave të shkollimit për disa programe studimi **të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë** gjatë vitit akademik 2017-2018 në Universitetin e Tiranës, jepet Tabela 2 më poshtë:

Tabela 2- Tarifatat e Ciklit të Parë dhe Ciklit të Dytë<sup>19</sup>

<i>Program Studimi Cikli i Parë Bachelor</i>	<i>Kufiri maksimal i tarifës vjetore të shkollimit në një program të ciklit të parë (në lekë)</i>	<i>Program Studimi Cikli i Dytë</i>	<i>Tarifata totale e Shkollimit</i>
<i>Universiteti i Tiranës</i>		<i>Master Profesional (MP) Master i Shkencave (MSh)  Universiteti i Tiranës</i>	<i>Program i Parë  (në lekë)</i>
<b>Biologji</b>	25,000	<b>MP E drejtë Civile</b>	120,000
<b>Fizikë</b>	25 000	<b>MP Kontabilitet</b>	144,000,
<b>Filozofi</b>	40 000	<b>MP Mësuesi (arsim i mesëm)</b>	120,000
<b>Shkenca politike</b>	40,000	<b>MSh E Drejtë Civile</b>	150,000
<b>Ekonomik</b>	35,000	<b>MSh Shkenca Penale</b>	150,000
<b>Financë</b>	35,000	<b>MSh Marrëdhënie Ndërkombëtare</b>	150,000
<b>Drejtësi</b>	40,000	<b>MSh Trashëgimi Kulturore</b>	150,000
<b>Mjekësi e përgjithshme</b>	45,000	<b>MSh Kimi Industriale e Mjedisore</b>	168,000
<b>Farmacit</b>	45,000	<b>MSh Kontabilitet dhe Auditim</b>	210,000
<b>Stomatologji</b>	45,000	<b>MSh Financë</b>	210,000
<b>Infermieri e përgjithshme</b>	40,000	<b>MSh Psikologji Klinike</b>	168,000

Në kuadër të Paktit për Universitetin u miratuan disa Vendime të Këshillit të Ministrave të cilat pretendojnë të adresojnë kërkesën e studentëve për përgjysmimin e të gjitha tarifave të shkollimit për ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve.

<sup>19</sup>Të dhënat për tarifatat e ciklit të parë të studimeve janë marrë nga VKM Nr. 288, datë 21.5.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”. Universitetet Publike kanë vendosur si tarifa përfundimtare të ciklit të parë të studimeve të njëjtat tarifa të përcaktuara si tarifa tavan nga kjo VKM. Të dhënat për tarifatat e ciklit të dytë të studimeve janë marrë nga -Vendimi i Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, Nr. 13 datë 06.07.2017 “Për miratimin e tarifave të shkollimit për programet e ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2017-2018”.

## 1. Tarifa e Shkollimit për Ciklin e Parë

Tarifat e shkollimit të ciklit të parë u ndryshuan me VKM 788, datë 26 dhjetor 2018<sup>20</sup>. Pika 1 e VKM-së 788 parashikon uljen e kufirit maksimal (tavanit) të tarifave për ciklin e parë të studimeve në masën 50% për të gjithë studentët. Gjithashtu pika 1 e VKM-së 788 zotohet se këto tarifa të përgjysmuara do të zbatohen për vitin akademik 2018-2019 si dhe për vitet në vijim. Pavarësisht këtij angazhimi në Pikën 1 të VKM-së 788, Pika 1/1 e po të njëjtës VKM e kufizon numrin e studentëve që do të përfitojnë nga ky përgjysmim. Më konkretisht, ajo parashikon se “*Studentët, të cilët rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik, nga viti akademik 2019–2020 e në vijim paguajnë tarifën e plotë të studimit*”.

Kjo politikë publike e përgjysmimit së tarifës bazuar tek mesatarja e notave të studentëve paraqet disa probleme. **Së pari** bie ndesh me **kërkesën e studentëve për përgjysmimin e tarifës për të gjithë**. **Së dyti** mund të ketë efekte diskriminuese ndaj studentëve në kushte të vështira ekonomike të cilët punojnë, shpesh me kohë të plotë, duke cenuar rrjedhimisht mesataren. **Së treti**, kriteri i meritës bie tërësisht ndesh me debatin e fundit publik për abuzimet në mësimdhënie dhe korrupsionin<sup>21</sup> në universitetet shqiptare të njohura e të pranuar edhe nga kryeministri<sup>22</sup>. Rrjedhimisht, në situatën aktuale nota mesatare nuk dëshmon domosdoshmërisht për meritokracione e rezultateve të studimeve.

## 2. Tarifa e Shkollimit për Ciklin e Dytë

Për trajtimin e kërkesës së studentëve në lidhje me përgjysmimin e tarifave të ciklit të dytë të studimeve qeveriasht qiptare miratoi VKM Nr. 780 datë 26 Dhjetor 2018<sup>23</sup>. **Ky vendim në fakt nuk përgjysmon tarifat e studimeve të ciklit të dytë (Master) për të gjithë studentët, por identifikon disa kategori studentësh të cilët do të paguajnë vetëm 50% të tarifës vjetore të studimit**<sup>24</sup>. Këto kategori janë:

- i. Studentët me aftësi të kufizuara (ku përfshihen studentët e verbër; studentët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe të tjerë në varësi të situatës);<sup>25</sup>;
- ii. Studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, që trajtohen me ndihmë ekonomike<sup>26</sup>; Studentët nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike<sup>27</sup>;
- iii. Studentët vetëm me një prind, me të ardhura vjetore të pamjaftueshme deri në moshën 25 vjeç<sup>28</sup>;

<sup>20</sup>VKM 788 datë 26.12.2018 “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 288, datë 21.5.2018, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar”

<sup>21</sup><https://www.youtube.com/watch?v=d16pYEVeRbY>

<sup>22</sup><https://www.kryeministria.al/newsroom/mbi-dokumentin-e-punes-mbi-paktin-per-universitetin/>

<sup>23</sup>VKM Nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”.

<sup>24</sup>Pika 1, VKM 780, datë 26.12.2018.

<sup>25</sup>Pika 1(a), VKM 780, datë 26.12.2018.

<sup>26</sup>Po aty.

<sup>27</sup>Pika 1 (b), VKM 780, datë 26.12.2018.

<sup>28</sup>Po aty.

- iv. Studentët deri në 25 vjeç të cilët kanë statusin e jetimit<sup>29</sup>; kanë humbur kujdestarinë prindërore<sup>30</sup>; kanë statusin e viktimave të trafikut të qenieve njerëzore<sup>31</sup>;
- v. Studentët fëmijë të disa kategorive punonjësish të forcave të rendit dhe sigurisë që kanë humbur jetën në detyrë<sup>32</sup>;
- vi. Studentët romë dhe ballkano-egjiptianë<sup>33</sup>;
- vii. Studentët fëmijë të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë<sup>34</sup>;
- viii. Studentët që kanë përfunduar ciklin e parë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë)<sup>35</sup>;
- ix. Studentët me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) në vitin e parë të ciklit të dytë<sup>36</sup>;

Janë të identifikueshme disa problematika në lidhje me parashikimet e këtij vendimi. **Së pari, ashtu si në rastin e tarifave të ciklit të parë, edhe në këtë rast vendimi nuk e përmbush kërkesën e studentëve për përgjysmimin e tarifave për të gjithë studentët.**

Së dyti vendimi **bie ndesh me disa ligje të posaçme për kategoritë e mbrojtura**. Më konkretisht:

- i. **Ligji për Statusin e të Verbërit**<sup>37</sup>: megjithëse të verbërit nuk përmenden specifikuat nga vendimi ata përfshihen në kategorinë e studentëve me aftësi të kufizuara. Neni 8 i Ligjit për Statusin e të Verbërit parashikon se “*Arsimimi i të verbërve në sistemin shtetëror bëhet falas*”. Si rrjedhojë VKM 780 është në kundërshtim të plotë me ligjin e posaçëm për të verbërit. **Në mënyrë paradoksale VKM-ja pretendon se ul tarifën për këtë kategori, kur në të vërtetë e ngarkon këtë kategori me një tarifë që nuk duhet ta paguajë.** Kjo e drejtë e fituar nga të verbërit me ligjin e tyre të posaçëm nuk mund të cenohet as me Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili është një akt i rangut inferior kundrejt ligjit, dhe as me një ligj që rregullon ndonjë fushë tjetër (p.sh. Ligji për Arsimin e Lartë). Kjo sepse sipas parimit të njohur juridik *lex specialis derogat legi generali* (**ligji i posaçëm qëndron mbi ligjin e përgjithshëm**) ligji për statusin e të verbërit mbizotëron dhe mund të ndryshohet vetëm me një ligj specifik për statusin e të verbërit.
- ii. **Ligji për Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik**<sup>38</sup>: Neni 8 i këtij ligji parashikon se “*shteti favorizon arsimimin e të sëmurëve paraplegjikë në shkollat e larta të sistemit shtetëror*”. Në këtë rast, ndryshe nga të verbërit, nuk përmendet shprehimisht termi “arsim falas”. Por, pavarësisht mangësisë së ligjit, për të shmangur diskriminimin (Neni 18 i Kushtetutës) dhe për të garantuar trajtimin e barabartë mes kategorive të mbrojtura me aftësi të kufizuara, edhe kjo kategori duhet të

<sup>29</sup>Pika 1 (c), VKM 780, datë 26.12.2018.

<sup>30</sup>Pika 1 (ç), VKM 780, datë 26.12.2018.

<sup>31</sup>Pika 1 (d), VKM 780, datë 26.12.2018.

<sup>32</sup>Pika 1 (dh), VKM 780, datë 26.12.2018. Studentët e përfshirë janë: fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit; Gardës së Republikës; Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat; të Shërbimit për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin; të Forcave të Armatosura; të SHISH; të Policisë së Burgjeve; të punonjësve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

<sup>33</sup>Pika 1 (e), VKM 780, datë 26.12.2018.

<sup>34</sup>Pika 1 (ë), VKM 780, datë 26.12.2018.

<sup>35</sup>Pika 1 (f), VKM 780, datë 26.12.2018.

<sup>36</sup>Pika 1 (g), VKM 780, datë 26.12.2018.

<sup>37</sup>Ligji Nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar.

<sup>38</sup>Ligji Nr. 8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar.

çlirohet tërësisht nga barra e tarifave dhe jo të ngarkohet nga VKM 780 me tarifa të përgjysmuara. Të njëjtat parime vlejnë edhe për invalidët e tjerë të cilët rregullohen nga Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për invalidët”, i ndryshuar.

- iii. **Ligji për trajtimin ekonomik dhe financiar për familjet e punonjësve të forcave të rendit / sigurisë**<sup>39</sup>: Neni 5i këtij ligji parashikon se “*Shteti merr përsipër trajtimin me bursë të plotë për të gjithë fëmijët e punonjësve...të cilët kanë fituar të drejtën e ndjekjes së studimeve në institucionet publike shtetërore të arsimit të lartë brenda vendit*”. Ligji nuk e përkufizon termin “bursë e plotë” por është praktikë e njohur, edhe ndërkombëtare, që në konceptin e bursës së plotë përfshihet si tarifa e studimit ashtu edhe një kuotë mujore që i jepet studentit për mbulimin e shpenzimeve të jetesës. Në këto kushte, sërish VKM 780 është në kundërshtim me ligjin specifik pasi ajo ngarkon fëmijët e kësaj kategorie të mbrojtur me pagesën e 50% të tarifave të ciklit të dytë në një kohë kur, sipas ligjit specifik, ato duhet të mbulohen nga bursa e plotë.

**Së treti, VKM 780 përdor sistemin e notës mesatare për përgjysmimin e tarifave të shkollimit të ciklit të dytë për të gjithë studentët të cilët nuk bëjnë pjesë në kategoritë specifike.** Për më tepër, ndryshe nga vendimi për tarifa e ciklit të parë, **zbaton një mesatare vjetore mjaft të lartë nga 9 deri në 10.** Siç u theksua edhe më lart, kjo politikë publike e përgjysmimit të tarifave bazuar në mesatare nuk merr parasysh një sërë veçorish të ekonomisë shqiptare dhe sistemit të arsimit të lartë.

Nga pikëpamja ekonomike ai mund të prodhojë **efekte diskriminuese** ndaj studentëve në kushte të vështira ekonomike të cilët për shkak se janë të detyruar të punojnë për përballimin e shpenzimeve, nuk mund të arrijnë mesatare të larta. Edhe më **kontradiktore** është vendosja e kriterit të “meritokracisë studentore” brenda një sistemi të arsimit të lartë i cili ende nuk është i certifikuar përsa i përket cilësisë së tij. Në fakt Kodi i Cilësisë së arsimit të lartë (Kodi i Cilësisë) është miratuar vetëm në Shtator të vitit 2018<sup>40</sup> dhe zbatimi i tij për IAL-et publike ende nuk ka nisur. Sa për ilustrim Kodi i Cilësisë radhit disa standarde për matjen e cilësisë në arsimin e lartë, mes të tjerash edhe këto:

- i. **Standardin II. 4** sipas të cilit “*Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formues, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve...*”<sup>41</sup>. Por sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) vlerësimi i standardeve dhe akreditimi i programeve të studimit për IAL-et publike ende nuk ka nisur (janë akredituar 251 programe studimi të IAL-eve private dhe 0 të tilla të IAL-eve publike)<sup>42</sup>.

<sup>39</sup>Ligj Nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit të kontrollit të brendshëm, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit, të forcave të armatosura, të shërbimit informativ shtetëror dhe të policisë së burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”.

<sup>40</sup> VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”.

<sup>41</sup>Po aty, fq. 9224.

<sup>42</sup><https://www.ascal.al/sq/akreditimi/programe-te-akredituara>

- ii. **Standardin II. 5** sipas të cilit “*Personeli akademik dhe ndihmës akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies*”<sup>43</sup>. Edhe në këtë rast cilësia e mësimdhënies dhe e kualifikimit të personelit akademik është në qendër të debatit për arsimin e lartë dhe paraqet ende shumë mangësi. Ky fakt është pranuar nga qeveria jo vetëm me deklarata por edhe me miratimin e akteve nënligjore të tilla si: VKM Nr. 783 datë 26.12.2018 “*Për vlerësimin e performancës në mësimdhënie të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, edhe nëpërmjet sondazhit kombëtar të studentëve*”; dhe VKM Nr. 777 datë 26.12.2018 “*Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore*”. Këto vendime të miratuara vetëm pak ditë më parë ende nuk kanë nisur zbatimin e tyre, duke mundësuar kështu garantimin e cilësisë së mësimdhënies apo përshtatshmërisë së kualifikimit të akademikëve shqiptar.
- iii. **Standardin IV.4** sipas të cilit “*Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit*”<sup>44</sup>. Një tjetër pikë kryesore e debatit publik dhe protestës së studentëve është gjendja e degraduar strukturore e universiteteve publike të cilat kanë mangësi të theksuara në salla mësimore dhe biblioteka.

Në kushtet e mungesës së vlerësimit të cilësisë së universiteteve publike si dhe problemeve publikisht të pranuar të mangësive në mësimdhënie, mjediseve të papërshtatshme universitare dhe ekzistencës së korrupsionit<sup>45</sup>, politika publike që vendos si kriter përgjysmimi tarife “meritokracinë studentore” është kontradiktore dhe e pabazuar në situatën reale. Siç u tha edhe më sipër, në kushtet aktuale, nota mesatare nuk dëshmon vërtetë për meritokracionë e studentëve për shkak të mangësive të vetë institucioneve. **Ky argument vlen edhe për VKM Nr. 779 datë 26.12.2018<sup>46</sup> e cila parashikon se përjashtohen nga tarifa vjetore e ciklit të parë të studimeve studentët me notë mesatare vjetore 9 deri në 10.**

#### IV. PESHA E VOTËS SË STUDENTËVE NË 50%

Një nga kërkesat e studentëve është rritja nga 10% në 50% e peshës totale të votës së studentëve për të zgjedhur dekanin dhe rektorin<sup>47</sup>. Në paketën ligjore të Paktit për Universitetin të datës 26 dhjetor 2018 nuk është miratuar asnjë akt që trajton këtë kërkesë. Rrjedhimisht kjo çështje vazhdon të rregullohet nga Ligji për Arsimin e Lartë i cili parashikon si më poshtë:

<sup>43</sup>VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “*Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë*”, fq. 9225.

<sup>44</sup>Po aty, Fq. 9229.

<sup>45</sup><https://www.youtube.com/watch?v=d16pYEVeRbY>

<sup>46</sup>VKM Nr. 779 datë 26.12.2018 “*Për disa ndryshime në vendimin nr. 269, datë 29.3.2017, të këshillit të ministrave, për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit*”, të ndryshuar.

<sup>47</sup><http://top-channel.tv/2018/12/09/protesta-studentet-perpilojne-kerkesat-e-panegociueshme/>



Neni 39 (2) i Ligjit për Arsimin e Lartë parashikon se Rektori zgjidhet me votat e personelit akademik dhe me votat e studentëve. Pesha e votës së studentëve është **“10 (dhjetë) për qind të totalit të përgjithshëm të votave”**. Si rrjedhojë plotësimin e kërkesës për rritjen në 50% të peshës së votës së studentëve në zgjedhjen e Rektorit e pengon Neni 39 (2) i Ligjit për Arsimin e Lartë.

Neni 42 (3) i Ligjit për Arsimin e Lartë parashikon se Dekani zgjidhet me votat e personelit akademik dhe me votat e studentëve. Pesha e votës së studentëve është **“10 (dhjetë) për qind të totalit të përgjithshëm të votave”**. Si rrjedhojë plotësimin e kërkesës për rritjen në 50% të peshës së votës së studentëve në zgjedhjen e Dekanit e pengon Neni 42 (3) i Ligjit për Arsimin e Lartë.

#### V. BORDI I ADMINISTRIMIT

Një tjetër kërkesë e studentëve ka të bëjë me Bordin e Administrimit dhe përbërjen e tij. Më konkretisht kërkohet që Bordi i Administrimit të ketë numër të barabartë anëtarësh nga ministria dhe IAL-i publik dhe gjithashtu të shtohet në përbërjen e tij një përfaqësues i studentëve<sup>48</sup>.

Përbërja dhe funksionimi i Bordit të Administrimit është një nga shtyllat kryesore të Ligjit për Arsimin e Lartë. Kjo sepse ky bord ushtron kompetenca të rëndësishme financiare të Institucionit të Arsimit të Lartë të cilat kanë ndikim thelbësor në autonominë financiare të institucionit. Aktualisht përbërja e Bordit të Administrimit rregullohet nga Neni 48 i Ligjit për Arsimin e Lartë i cili përcakton se bordi përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. Disa prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL dhe zgjidhen nga Senati Akademik, ndërsa anëtarët e tjerë janë përfaqësues të Ministrisë së Arsimit. Numri i anëtarëve që ka secili institucion në bord varet nga burimi i buxhetit. Kështu në rast se IAL siguron vetë 50% të buxhetit, shumica e anëtarëve (4) emërohen nga IAL dhe pakica (3) nga Ministria e Arsimit. Në rast të kundërt, ministria do të ketë shumicën. Gjithashtu parashikohet se Njësia e Qeverisjes Vendore që financon të paktën 10% të buxhetit të IAL, do të marrë një vend në bord nga vendi i përfaqësuesve të Ministrisë.

Me paketën e akteve nënligjore të Paktit për Universitetin u miratua VKM Nr. 782 e cila vendos kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit që janë përfaqësues të Ministrisë së Arsimit. Pika 6 e vendimit parashikon se një nga anëtarët përfaqësues të Ministrisë së Arsimit do të zgjidhet nga studentët. Megjithatë caktimi i numrit të anëtarëve përfaqësues të IAL dhe të Ministrisë në Bordin e Administrimit nuk ndryshon dhe vazhdon të përcaktohet nga institucioni që garanton 50% të buxhetit.

**Si rrjedhojë VKM 782 nuk e ka plotësuar kërkesën, sepse plotësimi i kërkesës së studentëve për ndryshimin e përbërjes së Bordit të Administrimit, në thelb pengohet nga Neni 48 i Ligjit për Arsimin e Lartë.**

<sup>48</sup> Po aty.

## VI. SHFUQIZIMI I LIGJIT PËR ARSIMIN E LARTË

Disa prej studentëve por edhe një numër pedagogësh<sup>49</sup> kërkojnë shfuqizimin e Ligjit për Arsimin e lartë. Lind pyetja nëse ky shfuqizim është i nevojshëm jo vetëm për realizimin e këtyre kërkesave, por edhe për rregullimin e problematikave me të cilat ndeshet sektori i arsimit të lartë në Shqipëri.

Siç u përmend edhe më sipër, janë disa nene të Ligji për Arsimin e Lartë të cilat pengojnë realizimin e kërkesave të studentëve. Neni 39 (2) i ligjit mbi zgjedhjen e Rektorit pengon plotësimin e kërkesës për rritjen në 50% të peshës së votës së studentëve; Neni 42 (3) i ligjit mbi zgjedhjen e Dekanit pengon plotësimin e kërkesës për rritjen në 50% të peshës së votës së studentëve.

Vlen për t'u përmendur edhe çështja e **bursave** e cila u përfshi nga qeveria shqiptare në paketën nënligjore të Paktit për Universitetin. Më konkretisht me VKM Nr. 784<sup>50</sup> u ndryshua kriteri i notës mesatare të studentëve të shkëlqyer në notën 9 (nëntë) nga 10 (dhjetë) që ishte më parë. Megjithatë ky vendim është në kundërshtim me Nenin 112 (4) të Ligjit për Arsimin e Lartë pasi ky nen parashikon se "*Bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen studentëve me notë mesatare maksimale...*". Padyshim që nota maksimale në Shqipëri është nota 10 (dhjetë) rrjedhimisht edhe nota mesatare maksimale është sërish nota 10 (dhjetë). Ndaj edhe në këtë rast është **Neni 112 i Ligjit për Arsimin e Lartë që pengon uljen e notës mesatare për studentët e shkëlqyer** dhe pa ndryshimin e këtij neni asnjë VKM nuk mund të vendosë ndryshe.

Megjithatë nenet e mësipërme mund të ndryshohen pa u prekur në thelb fryma e Ligjit për Arsimin e Lartë. Më problematike janë disa nene të tjera që prekin shtylla kryesore të Ligjit për Arsimin e Lartë. Më konkretisht:

### i. Financimi i IAL-eve publike

Kërkesa për rritjen e financimit për arsimin publik deri në 5% të PBB-së e cila u trajtua edhe më sipër, edhe sikur të realizohej me transferimin e fondeve përkatëse, do të pengohej nga Ligji për Arsimin e Lartë. Kjo sepse Neni 107 i Ligjit për Arsimin e Lartë parashikon se një nga parimet bazë të financimit të IAL nga Buxheti i shtetit është "**Konkurrenca e lirë mes institucioneve që gëzojnë të njëjtin status sipas nenit 17 të ligjit**"<sup>51</sup>. Cilat janë institucionet e arsimit të lartë (IAL) me të njëjtin status sipas nenit 17 të Ligjit?

Ato janë institucionet publike, institucionet jopublike dhe institucionet publike të pavarura (IALPP). Këto të fundit janë një kategori e re e cila sipas Nenit 118 konsistojnë në institucione të krijuara nga një organizatë jofitimprurëse e llojit fondacion. Ligji nuk parashikon kushtin që fondacioni të jetë i themeluar

<sup>49</sup><http://gazeta-shqip.com/lajme/2018/12/23/ligji-per-arsimin-e-larte-51-pedagoge-kerkojne-shfuqizimin/>

<sup>50</sup>VKM Nr. 784 datë 26.12.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 903, datë 21.12.2016 "Pë përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë" të ndryshuar".

<sup>51</sup>Neni 107 (a), Ligji për Arsimin e Lartë.

domosdoshmërisht nga ndonjë organ publik ndaj ekziston hapësira ligjore që edhe një privat i cili themelon një fondacion mund të krijojë një IALPP i cili do të konsiderohet për një arsye të pakuptueshme si IAL publik. Si rrjedhojë IAL-et publike klasike, do të konkurrojnë për fonde publike si me IAL-et private ashtu edhe me llojin e ri të IALPP-ve kufijtë privato-publike të të cilit janë të mjegullta. **Përfundimisht edhe në rast se 5% e PBB-së do të financojë arsimin e lartë, pjesa që do të marrë prej tij arsimit i lartë publik do jetë në varësi të konkurrencës me institucionet e tjera private dhe privato-publike.**

Si rrjedhojë, e vetmja mënyrë e realizimit të kërkesës së financimit të arsimit publik me 5% të PBB-së është ndryshimi i parimit të konkurrencës mes IAL-eve publike dhe atyre private. Por ndryshimi i një nga shtyllave kryesore të ligjit për arsimin e lartë do të kërkonte logjikisht rikonceptimin dhe shfuqizimin e këtij ligji.

## ii. Autonomia Financiare e IAL-eve publike

Një tjetër nga parimet bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë është ai i autonomisë financiare. Që në Nenin 3 të tij ligji parashikon se IAL-et gëzojnë liri akademike, **autonomi financiare** dhe organizative. Por çfarë është autonomia financiare?

*European University Association* (EUA), e cila është organizata që përfaqëson më shumë se 800 universitete dhe konferenca të rektorëve të 48 vendeve Evropiane<sup>52</sup> ka hartuar një instrument matës të autonomisë së universiteteve<sup>53</sup>. Një nga elementet e autonomisë është edhe **autonomia financiare** e cila përkufizohet si “*aftësia e universitetit të menaxhojë fondet dhe të shpërndajë buxhetin në mënyrë të pavarur*”<sup>54</sup>. Në përputhje me studimin e EUA-së mbi pavarësinë e Universiteteve në Evropë në vitin 2017, masat kufizuese në përdorimin e granteve publike që u jepen universiteteve e minojnë autonominë financiare. Si shembull është sjellë Hungaria ku jo vetëm kufizohet shpërndarja e fondeve mes zërave të ndryshme të grantit, por edhe ekziston detyrimi i miratimit të vendimeve financiare nga një organ i emëruar nga Kryeministri, siç është kancelari. Kjo metodë konsiderohet të ketë një impakt mbi kapacitetin e universitetit për të pasur vendimmarrje në shpërndarjen e fondeve të brendshme<sup>55</sup>.

Në përputhje me parimet e mësipërme edhe Ligji për Arsimin e Lartë, parashikon në nenin 3 (3) (c) se autonomia financiare është mes të tjerash edhe autonomi për të caktuar rregullat e brendshme për shpërndarjen dhe përdorimin e të ardhurave sipas nevojave të institucionit. Por si zbatohet konkretisht kjo autonomi?

<sup>52</sup><https://eua.eu/about/who-we-are.html>

<sup>53</sup><https://www.university-autonomy.eu/>

<sup>54</sup><https://www.university-autonomy.eu/dimensions/financial/>

<sup>55</sup> By Enora Bennetot Pruvot and Thomas Estermann, *University Autonomy in Europe III, The Scorecard 2017*, fq.21

<https://eua.eu/downloads/publications/university%20autonomy%20in%20europe%20iii%20the%20scorecard%202017.pdf>

Neni 108 i Ligjit për Arsimin e Lartë për autonominë financiare të IAL-eve parashikon në paragrafin 4 se “përdorimi i fondeve publike nga Buxheti i Shtetit... behet në përputhje me **kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar**”. Si rrjedhojë, parimisht autonomia financiare e IAL-eve publike në shpërndarjen dhe përdorimin e fondeve do të kufizohet nga kushtet dhe qëllimet e grantit.

Për më tepër organi më i lartë administrativ i IAL-eve publike, me funksione të rëndësishme për financat e IAL, është Bordi i Administrimit. Siç u tha edhe më sipër përbërja e bordit varet nga masa e financimit. Kështu sipas nenit 48 në rast se shteti do të vazhdojë të financojë 50% e më shumë të buxhetit të IAL-eve publike atëherë do të ketë edhe shumicën e votave të Bordit të Administrimit, pra kontrollin në vendimmarrjen financiare të IAL-it publik. Kjo sepse Bordi i Administrimit miraton Buxhetin sipas propozimit të Senatit Akademik<sup>56</sup>. Gjithashtu Bordi i Administrimit (pa propozim të Senatit Akademik) cakton edhe rregullat e shpërndarjes së fondeve që IAL-et publike i krijojnë vetë<sup>57</sup>. Në këto kushte autonomia financiare e IAL-eve publike në Shqipëri paraqitet si më poshtë:

- i. Mungesë autonomie në shpërndarjen e fondeve të ardhura nga buxheti i shtetit për shkak të grantit të kufizuar;
- ii. Mungesë autonomie në vendimmarrjen financiare për shkak të mungesës së shumicës së votave në Bordin e Administrimit;
- iii. Mungesë autonomie në shpërndarjen e fondeve të veta për shkak të mungesës së shumicës së votave në Bordin e Administrimit.

Si rrjedhojë autonomia financiare e IAL-eve publike shqiptare paraqitet e ngjashme me rastin e kritikuar të Hungarisë. Për më tepër Ligji për Arsimin e Lartë, me nenet zbatuese të autonomisë financiare, tradhton parimin e shprehur në Nenin 3 të tij. Si rrjedhojë, Ligji për Arsimin e Lartë është në kundërshtim me standardet e mira të autonomisë financiare të identifikuar nga EUA, por edhe në kundërshtim me parimet e veta. Ndaj e vetmja mundësi për rregullimin e kësaj situatë është shfuqizimi i Ligjit për Arsimin e Lartë dhe rikonceptimi i plotë i tij.

## VII. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Si rrjedhojë e analizës së mësipërme mund të nxirren përfundimet vijuese:

1. Kërkesa për rritjen e financimit publik deri në 5% PBB nuk është realizuar dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi nuk parashikojnë realizimin e saj për periudhën 2019-2021.
2. Kërkesa për përgjysmimin e tarifës së shkollimit për të gjithë studentët në ciklin e parë të studimeve është realizuar vetëm për vitin 2018-2019. Pas këtij viti do të përfitojnë nga ky përgjysmim vetëm studentët me notë mesatare 6 (gjashtë) e sipër;
3. Kërkesa për përgjysmimin e tarifës së shkollimit për të gjithë studentët në ciklin e dytë nuk është realizuar. Vendimi i miratuar nga qeveria nuk përgjysmon tarifat e studimeve të ciklit të dytë

<sup>56</sup>Neni 49 (1) (c), *Ligji për Arsimin e Lartë*

<sup>57</sup>Neni 49 (1) (ë), *Ligji për Arsimin e Lartë*

(Master) për të gjithë studentët, por identifikon disa kategori studentësh të cilët do të paguajnë vetëm 50% të tarifës vjetore të studimit<sup>58</sup>.

4. VKM 780 që përgjysmon tarifat Master për disa kategori studentësh, detyron studentët e verbër të paguajnë gjysmën e tarifës së masterit ndërkohë që Ligji për Statusin e të Verbërit parashikon se arsimi për të verbërit është falas. Si rrjedhojë ky vendim është në kundërshtim me këtë ligj. Bazuar në parimin e mos-diskriminimit kjo vlen edhe për Studentet me status invalid paraplegjikë, tetraplegjikë dhe invaliditet të një lloji tjetër.
5. VKM 780 e cila përgjysmon tarifat Master për disa kategori studentësh, detyron studentët të cilët janë fëmijë të punonjësve të forcave të rendit / sigurisë të rënë gjatë detyrës të paguajnë gjysmën e tarifës së masterit ndërkohë që ligji specifik për trajtimin ekonomik dhe financiar të kësaj kategorie<sup>59</sup> parashikon pajisjen e tyre me bursë të plotë.
6. Përdorimi i notës së lartë mesatare (nga 9 deri në 10) për përgjysmimin e tarifave të Masterit nga VKM 780 është **diskriminuese, jo proporcionale dhe në mospërputhje me situatën aktuale** të arsimit të lartë.
  - i. **Diskriminuese** sepse mund të diskriminojë studentët në kushte të vështira ekonomike të cilët për shkak se janë të detyruar të punojnë për përbalimin e shpenzimeve, nuk mund të arrijnë mesatare të larta.
  - ii. **Joproportionale** sepse vendos kriterin e “meritokracisë studentore” brenda një sistemi të arsimit të lartë i cili ende nuk është i certifikuar përsa i përket cilësisë së tij: (a) janë akredituar 251 Programe studimi të universiteteve private dhe **0 programe studimi të universiteteve publike**;<sup>60</sup> (b) Nuk ka nisur ende vlerësimi i performancës së mësimdhënies të personelit akademik dhe kontrolli antiplagjiaturë i gradave shkencore pasi VKM-të përkatëse janë miratuar në 26 Dhjetor 2018; (c) është pranuar publikisht nga të gjithë palët se ka mangësi thelbësore në ‘*mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dheliteraturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies...*’<sup>61</sup> siç kërkohet nga standardet e cilësisë.
  - iii. **Në mospërputhje me realitetin** e kushteve të arsimit të lartë për shkaqet e mësipërme.
7. Kërkesa për rritjen nga 10% në 50% të peshës totale të votës së studentëve për të zgjedhur dekanin dhe rektorin nuk është trajtuar në paketën nënligjore të Paktit për Universitetin. Kjo kërkesë nuk mund të realizohet pa ndryshimin e neneve 39 (2) dhe 42 (3) të Ligjit për Arsimin e Lartë.
8. Kërkesa që Bordi i Administrimit të ketë numër të barabartë anëtarësh nga ministria dhe IAL dhe një përfaqësues të studentëve nuk është realizuar nga VKM Nr. 782, që parashikon vetëm se një nga

<sup>58</sup>Pika 1, VKM 780, datë 26.12.2018.

<sup>59</sup>Ligj Nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit të kontrollit të brendshëm, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit, të forcave të armatosura, të Shërbimit informative shtetëror dhe të policisë së burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”.

<sup>60</sup><https://www.ascal.al/sq/akreditimi/programe-te-akredituara>

<sup>61</sup>Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë, Standardi IV.4.

anëtarët përfaqësues të Ministrisë së Arsimit do të zgjidhet nga studentët. Kjo kërkesë nuk mund të realizohet pa ndryshimin e Nenit 48 të Ligjit për Arsimin e Lartë.

9. VKM Nr. 784<sup>62</sup> e cila ndryshoi kriterin e notës mesatare për bursat e studentëve të shkëlqyer në notën 9 (nëntë) nga 10 (dhjetë) që ishte më parë është në kundërshtim me Nenin 112 (4) të Ligjit për Arsimin e Lartë që parashikon se *“Bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen studentëve me notë mesatare maksimale...”*. Nota maksimale në Shqipëri është nota 10 (dhjetë) rrjedhimisht edhe nota mesatare maksimale është sërish nota 10 (dhjetë). Ndaj edhe në këtë rast vetëm me ndryshimin e **Nenit 112 të Ligjit për Arsimin e Lartë mund të realizohet ulja e notës mesatare për studentët e shkëlqyer.**
10. Ligji për Arsimin e Lartë shkakton probleme thelbësore në sistemin e arsimit të lartë publik:
  - i. **Zvogëlon financimin e IAL-eve publike nga buxheti i shtetit:** duke parashikuar parimin e konkurrencës për fondet publike mes IAL-eve publike, IAL-eve private dhe IALPP-ve (një kategori e re që krijohet nga një organizatë jofitimprurëse e llojit fondacion).
  - ii. **Cenon Autonomisë Financiare të IAL-eve publike:** me anë të mungesës së autonomisë në shpërndarjen e fondeve të ardhura nga buxheti i shtetit për shkak të grantit të kufizuar; mungesës së autonomisë në vendimmarrjen financiare për shkak të mungesës së shumicës së votave në Bordin e Administrimit; mungesë së autonomisë në shpërndarjen e fondeve të veta për shkak të mungesës së shumicës së votave në Bordin e Administrimit.

Për arsytet e mësipërme rekomandohet si veprim i menjëhershëm **përgjysmimi i tarifave të shkollimit për të gjithë studentët pavarësisht ciklit ku ndodhen apo kategorisë specifike.**

Gjithashtu është detyrim ligjor i cili duhet zbatuar nga aktet nënligjore, **përfundimi nga tarifat e ciklit të dytë për ato kategori të cilat e kanë fituar këtë të drejtë me ligj të posaçëm.**

Bëhet i domosdoshëm shfuqizimi i Ligjit për Arsimin e Lartë dhe nisja e menjëhershme e rikonceptimit të arsimit të lartë në Shqipëri në respektim të parimeve të mbështetjes dhe fuqizimit të arsimit të lartë publik nga shteti shqiptar dhe garantimin e autonomisë reale financiare të universiteteve publike shqiptare.

<sup>62</sup>VKM Nr. 784 datë 26.12.2018 *“Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 903, datë 21.12.2016 “Pë përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” të ndryshuar”*.